



Planuar / Dorezuar Prilbjen/Prudatu Received/Delivery	12.04.2022	2	viti god Year
Organ /Njesia Organ /Jedinita Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHUK	2039/2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.245/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.245/2022 të datës 17.03.2022 të parashtruar nga [redacted] me adresë [redacted] Prishtinë, kundër Njoftimit të datës 10.03.2022 për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.245/2022 e datës 17.03.2021 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] më datë 17.03.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1420/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 10.03.2022 për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa ky i fundit më datë 01.04.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.245/2022 të datës 17.03.2022 me numër protokolli /2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 17.03.2022 të ankuesit; Konkursin për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatën e Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve i shpallur më datë 21.01.2022; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Shkresë e datës 29.07.2019 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Akt Emërimit e datës 01.09.2020 të ankuesit; Lista e kandidatëve të subjekteve politike për zgjedhjet për Kuvendin Komunal Gjakovës 2021; Vendimin e datës 28.10.2021 për caktimin e ankuesit zëvendësues në pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Formularin e vlerësimit të kryerjes për periudhën 01.09.2020 deri 12.07.2021; Vendimin e datës 15.07.2021 për caktimin e ankuesit ushtrues detyre në pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Lista e kandidatëve të subjekteve politike për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.03.2022; Përgjigje në ankesë e datës 01.04.2022; Vendimin e datës 21.01.2022 nga Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Vendimin e datës 14.02.2020 për formimin e Komisionit Përzgjedhës për Pozitat Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në SKQZ dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC; Emailin e datës 08.02.2022; Emailin e datës 22.02.2021 për rikujtues për intervista; Emailin e datës 14.02.2022 për kërkesë për verifikim; Emailin e datës 14.02.2022 për verifikim të kandidatëve për ZVKE; Listën e kandidatëve për ZVKE; Formularin Form.KQZ-R-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirë në listën e ngushtë; Shkresën me pikët e kandidatëve datës 15.02.2022; Raportin nga Kryesuesi i Komisioni Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë i datës 16.02.2022; Lista e kandidatëve për verifikim; Emailin e datës 21.02.2022 për njoftim për pjesëmarrje në intervistë për kandidatët; Formulari për kriteret e vlerësimit të kandidatëve gjatë intervistës me gojë; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Raportin e Komisionit Përzgjedhës për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ i datës 01.03.2022; Vendimin e datës 09.03.2022 për emërimin e Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së; Ankesë për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga kandidati F.Z; Vendimin e datës 28.03.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së për vendosje të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me çështjen në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit A.nr.245/2022 e datës 17.03.2022, është e palejuar, sepse:

Nga administrimin i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datë 21.01.2022 ka shpallur Konkursin KQZ-01/2022 për pozitën e punës Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. I njëjti është përfshirë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit për këtë pozitë.

Njësia e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 10.03.2022 ka publikuar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, respektivisht kandidati është shpallur si kandidati më i suksesshëm më gjithsej 89.40 pikë.

I pakënaqur me Njoftimin e datës 10.03.2022, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin së Njoftimi i datës 10.03.2022 për kandidatin e suksesshëm për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është nxjerrë në zbatim jo të drejtë dhe kundër akteve ligjore dhe nënligjore, duke shtuar së edhe pse në njoftimin për kandidatin e suksesshëm është dhënë

mundësia për ankimi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve edhe Ankesave në Sekretariatit e KQZ-së, nuk ka parashtruar ankesë në këtë Komision, sepse për dy raste të pozitive të larta i njëjti Komisioni nuk ka shqyrtuar ankesat duke e shpallur veten si jo kompetent.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Aktgjykimin Ref.Nr.AGJ 1363/19 të datës 20.02.2019 të Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Aktgjykimin KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht duke ju referuar pikës III të dispozitivit të këtij aktgjykimi ku është përcaktuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, dhe pikës 207 po të këtij aktgjykimi ku theksohet se: Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj Personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre”, Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në raport me institucionet e pavarura kushtetuese zbatohen aktet e tyre të brendshme dhe Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për aq sa nuk cenohet pavarësia e tyre.*

Bazuar në dëshmitë e ofruara nga palët në procedurë, konstatohet së ankuesi kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën *Zëvendës Kryeshf Ekzekutiv* në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk ka parashtruar fillimisht ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu siç përcaktohet me nenin 49 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku thuhet se: *Kur një nëpunës ose kandidat, në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon së emërimi i një personi tjetër në atë pozite nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasojë e parregullsive në zbatimin e rregullave dhe proceduarve, ai/ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit, i cili e shqyrton dhe vendos për ankesën, Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton se ankuesi paraprakisht kundër Njoftimit të datës 10.03.2022 është dashur të paraqes ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kurse në rast të pakënaqësisë me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i njëjti duke u bazuar në nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ka mundur të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Bazuar si me lart, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin është përcaktuar se: *Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton*

së ankesa A.nr.245/2022 e datës 17.03.2021 e parashtruar nga ankuesi [redacted] është e palejuar.

Përmbledhur si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.245/2022

**Avdyll BEKTESHI**

*[Signature]*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit [redacted]
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së

